



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I AVIACIONIT CIVIL
DREJTORI EKZEKUTIV

Nr. 283/prot.

Tiranë, më 23.11.2021

VENDIM

Nr. 23, datë 23.11.2021

PËR

MIRATIMIN E MANUALEVE UDHËZUESE

Në mbështetje të Nenit 13, gërma “g”, të Ligjit Nr. 10233, datë 11.02.2010 “Për Autoritetin e Aviacionit Civil”, të ndryshuar, Urdhrit të Ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë 122/2019, Urdhrit të Ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë 130/2012, SARP-eve të ICAO-s, si dhe me qëllim mbylljen e gjetjeve të USOAP për kategorinë e aerodromeve dhe garantimin e sigurisë në operim;

V E N D O S A:

1. Miratimin e Manualit Udhëzues “Menaxhimi i rrezikut nga bota shtazore në aerodrom”, O1.MU.05, Rishikimi 00.
2. Miratimin e Manualit Udhëzues “Matja dhe vlerësimi i karakteristikave të fërkimit në sipërfaqen e pistës dhe instruksione lidhur me metodologjinë e re të vlerësimit dhe raportimit të kushteve të sipërfaqes së pistës (GRF)”, O1.MU.06, Rishikimi 00.
3. Një kopje e këtij vendimi t’i dërgohet Operatorëve të Aerodromit dhe të publikohet në faqen zyrtare të AAC-së.
4. Me qëllim garantimin dhe përmirësimin e sigurisë në operim, ngarkohen Operatorët e Aerodromeve me zbatimin e parashikimeve të këtyre manualeve udhëzuese.
5. Drejtoria e Mbikëqyrjes së Aeroporteve ngarkohet për të garantuar zbatimin e manualeve.
6. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

DREJTOR EKZEKUTIV

Edlira Kraja

